



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1103/prot.
15

Tiranë, më 18.04 2023

V E N D I M

Nr. 29 datë 18.04 2023

"PËR

MIRATIMIN E BURSAVE TË STUDENTËVE DHE PËRJASHTIM NGA TARIFAT E SHKOLLIMIT TË CIKLIT TË PARË QË PLOTËSOJNË KRITERET, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"

Në zbatim të VKM nr. 903, dt. 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, me VKM nr. 39 datë 23.01.2019, VKM 269 datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të studimeve ... që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar me VKM nr. 40 datë 23.01.2019, Vendimit të Bordit të Administrimit nr.22 datë 26.04.2022 "Mbi miratimin e tarifave të shkollimit për të tre ciklet e studimeve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës", Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 55 datë 30.11.2022 "Për miratimin e dokumentacionit për përfitimin e bursës ose të përjashtimit nga tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të parë dhe përjashtimin nga tarifa e shkollimit 50% për studentët e ciklit të dytë për vitin akademik 2022-2023 dhe Relacionin e komisionit shqyrtimit përkatës nr. 245/3 datë 7.04.2023 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për aplikimet për bursë dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit", Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 18.04.2023,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar burs dhe për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2022-2023, sipas kriterëve të detajuar, sipas shtojcës 1, bashkëngjitur.
2. Të miratojë listën e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar burs, për vitin akademik 2022-2023 sipas kriterëve të detajuar, sipas shtojcës 2, bashkëngjitur.

3. Të miratojë listën e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për përjashtim nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023 sipas kriterëve të detajuar, sipas shtojcës 3, bashkëngjitur.
4. Të miratojë listën e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për përjashtim nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023 sipas kriterëve të detajuar, sipas shtojcës 4, bashkëngjitur.
5. Efektet financiare për studentët që kanë aplikuar brenda afateve të përcaktuara fillojnë nga fillimi i vitit akademik 2022-2023.
6. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë bursë dhe përjashtohen nga tarifat e shkollimit për vitin akademik 2022-2023 dhe me efektet financiare të dërgohet dhe në MAS.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqe www.ust.edu.al dhe tek trasparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI



Shtojca 1:

Lista e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar bursë dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023.

Kriteri nr.1: Studentët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Fakul .	Viti	Përfitues i bursës	Përfitues i prejashtimit	Efekti Financiar i Burses	
							Efekti Financiar i prejashtimit	
1	EF813A100135	A D	FVFR	2	Po	Po	17500	40,909
2	EF813A110332	S.Q	FSHR	1	Po	Po	17500	40,909
Shuma							35,000	81,818

Shtojca 2:

Lista e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar bursë, për vitin akademik 2022-2023.

Kriteri 6 Student i cili ka 2 prindërit pensionistë.

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Fakulteti	Viti	Përfitues i bursës	Efekti Financiar i Burses
1	EF813A110378	E.V	FSHL	1	Po	90,000
Shuma						90,000

Shtojca 3:

Lista e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për përjashtim nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023.

Kriteri 13 Student që vjen nga shtresa sociale : Studentët fëmijë të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar me heqje lirie.

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Fakulteti	Viti	Përfitues i përjashtimit	Efekt Financiar i Burses
1	EF813A100042	A. B	FVFR	2	Po	17.500
Shuma						17.500

Shtojca 4:

Lista e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përjashtuar nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023.

Kriteri nr. 14: Studentët të cilët kanë të paktën njërin prind person me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me KMCAP, përfitues i pagesës së aftësisë të kufizuar.

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Fakulteti	Viti	Përfitues i përjashtimit	Efekt Financiar i përjashtimit
1	EF813A090042	E. Sh	FSHL	3	Po	17,500
Shuma						17,500